



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KËSHILLI I QARKUT KORÇË

### VENDIM

NR. 10 DT 15.03.2024

#### “MBI MIRATIMIN E ZBATIMIT TË PROJEKTIT SHËRBIME DITORE KOMUNITARE PËR MOSHËN E TRETË, MIRATUAR NGA MINISTERIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE”

Bazuar në ligjin nr 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, ligjin nr 9335 datë 10.03.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore, i ndryshuar, nenin 38 të ligjit 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, VKM 563 datë 12.08.2005”, Për përcaktimin e përgjegjësive të Qarkut për shpërndarjen e shërbimeve të përkujdesit shoqëror”, VKM 111 datë 23.02.2018 “Për Krijimin dhe Funkcionimin e Fondit Social”, Vendim Nr. 864, datë 24.12.2019 “Për Miratimin e Dokumentit Politik Kombëtar për Moshimin, 2020–2024 dhe të Planit të Veprimit për Zbatimin e tij”, Këshilli i Qarkut,


#### VENDOSI:

1. Miratimin e zbatimit të projektit “Shërbime ditore Komunitare për Moshën e Tretë, e miratuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, nëpërmjet Fondit Social.
2. Vazhdimin e hapave të metejshme për ofrimin e shërbimeve ditore të përkujdesit shoqëror për moshën e tretë në Qendrat Komunitare.
3. Të miratojë shtimin në buxhet të vlerës 8,985,900 lekë për paga dhe sigurime shoqërore për 1 Menaxher Projekt, 1 Financier, 6 punonjës socialë si dhe 3 sanitarë, financuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
4. Miratimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit për vijimin e zbatimit të projektit.
5. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Sektori i Financës, zhvillimit ekonomik dhe shërbimeve.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Konceptoi: Paola Lara  
Kësh. juridik Gjergji Kristo  
Sekretar i K.të Qarkut: Bashkim Muço

KRYETAR I KËSHILLIT TË QARKUT

Erjon Nexhipi





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KËSHILLI I QARKUT KORÇË

### RELACION

#### **MBI MIRATIMIN E ZBATIMIT TË PROJEKTIT SHËRBIME DITORE KOMUNITARE PËR MOSHËN E TRETË, MIRATUAR NGA MINISTERIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE**

Në kuadër të funksionimit të Programit të Fondit Social, monitoruar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Qarkut Korçë së bashku me Bashkinë Korçë, Pogradec, Maliq në bashkëpunim me Fondaconin “Misioni Emanuel për Zhvillim dhe Integrim” paraqitën propozimin për mbështetje financiare për projektin : “Shërbime Sociale e Shëndetësore të Përshtatshme dhe të Integruara për të Moshuarit”, i cili ka si objekt ofrimin e shërbimeve të specializuara të përkujdesit shoqëror.

Ky projekt vjen si rezultat i bashkëpunimit disa vjeçar midis aktorëve të sipërcituar, i cili ka si qëllim zgjerimin e nivelit të shërbimeve ekzistuese të përkujdesit shoqëror dhe përfituesve, të ofruara nga Qendrat Ditore të Moshës së Tretë në nivel rajonal.

Objektivat e përgjithëm të projektit përfshijnë:

-Zgjerimin dhe forcimin e sistemit ekzistues të integruar të shërbimeve të kujdesit shoqëror i aftë të sigurojë shërbime të mbrojtjes, përkujdesit, integritit dhe përfshirjes për të moshuarit e vetmuar në përputhje me standartet kombëtare të shërbimeve të përkujdesit shoqëror si dhe planet sociale të bashkive respektive;

- Fuqizim të kapaciteteve institucionale, njerëzore, financiare, teknike të qendrave;

- Krijimin e një ambienti të përshtatshëm që mbështet dhe ndihmon të moshuarit e vetmuar për t'u integruar në shoqëri, duke ruajtur dinjitetin njerëzor, pavarësisht nga gjendja e tyre ekonomike, shoqërore, shëndetsore apo autonomia e tyre funksionale, nëpërmjet politikave vendore efektive;

Këto objektiva do të realizohen nëpërmjet shërbimeve dhe aktiviteteve dedikuar kësaj kategorie si: konsulta dhe këshillime sociale; shërbime ditore në Qendër; kujdes dhe ndihmë mjekësore; organizimi i aktiviteteve argësuese dhe festive; asistimi nga stafi i qendrave në përdorimin e teknologjisë (rrjeteve sociale dhe platformën e- Albania si dhe shërbimet që ajo ofron); të rinjtë ndihmojnë të moshuarit në fusha të ndryshme duke i ndihmuar ata të zhvillojnë aftësi të reja ose të përmirësojnë njohuritë; krijimi i një database me të dhëna të përditësuara për këtë kategori, duke përditësuar situatën për gjendjen dhe nevojat e tyre si dhe të gjitha shërbimet që do të përfitohen nga projekti etj

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nëpërmjet shkresës nr 807/3 datë 12.02.2024 na njofton se Komisioni i Vlerësimit të Kërkesave për Financimin e Ofrimit të Shërbimeve të

Përkujdesit Shoqëror, ka miratuar mbështetjen financiare për ofrimin e Shërbimeve Ditore Komunitare për Moshën e Tretë në Bashkitë e Qarkut Korçë nga Fondacioni “Misioni Emanuel për Zhvillim dhe Integrim”. Vlera e miratuar për 11 muaj për periudhën (shkurt- dhjetor 2024) është 8,985,900 lekë, për paga dhe sigurime shoqërore për 1 Menaxher dhe 1 Financier Projekti me pagë bruto 80 000 lekë, 6 punorjës socialë me pagë bruto 70 000 lekë si dhe 3 sanitarë me pagë bruto 40 000 lekë. Vlera e sipërcituar dhe e dedikuar për projektin në fjalë i shtohet buxhetit të miratuar të Këshillit të Qarkut Korçë të vitit 2024 sipas destinacionit dhe strukturës buxhetore të përcaktuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Në këto kushte kërkohet nga Këshilli i Qarkut Korçë miratimin e zbatimit të këtij projekti për të vijuar me hapat e metejshme për ofrimin e shërbimeve si dhe dokumentacionin e nevojshëm përfshirë marrëveshjet e bashkëpunimit me Bashkitë Korçë, Pogradec, Maliq dhe Fondacionin “Misioni Emanuel për Zhvillim dhe Integrim”, hartimin dhe nënshkrimin e kontratave të punës me punonjësit, sipas fondit të akorduar për paga nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale etj.

Bashkëngjitur marrëveshjet e bashkëpunimit me Bashkitë Korçë, Pogradec, Maliq dhe Fondacionin “Misioni Emanuel për Zhvillim dhe Integrim”.

Koncept.: Paola Lara



Kesh.juridik: Gjergji Kristo